



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 658/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bekim Ibishi, kandidat i pavarur në Skenderaj, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Bekim Ibishi, kandidat i pavarur në Skenderaj, me shenjën ZL.Anr.658/2017, e datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Bekim Ibishi, kandidat i pavarur në Skenderaj me datën 09.11.2017, me të cilën thekson se i është bërë parregullsi në Qendrat e Votimit të precizuar më hollësisht në ankesë, ashtu që votat e vlefshme janë shpallur si të pavlefshme, dhe ka kërkuar që të bëhet rinumërimi i votave në Qendra të Votimit: 2101B/01R, 2101B/02B, 2101B/03R, 2101B/04R, 2101X/01R, 2101X/02R, 2101X/03R, 2101X/04R, 2101X/05R, 2101X/06R, 2103B/01R, 2103B/02D, 210B/01R, 2105/02R, 2105B/03R, 2105B/04D, 2106B/01R, 2106B/02R, 2106B/03R, 2106B/04D, 2107B/01R, 2107B/02R, 2107B/03R, 2107B/04D, 2108B/01R, 2108B/02D, 2112B/01R, 2112B/02D, 2113B/01R, 2113B/02R, 2113B/3D, 2114B/01R, 2114B/02R, 2114B/3R, 2114B/04D, 2115B/04D, 2115B/03R, 2115B/02R, 2115R/01R, 216B/01R, 2116B/02B, 2116B/03D, 2121B/02R, 2121B/02D, 2119B/01D, 2130B/01R, 2130B/01R, 2129B/01D, 2132B/01R, 2132/02D, 2128B/01B, 2102B/01R, 2102B/02D, 2120B/01R, 212B/02B.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankuesit me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë për asnjë

vendvotim me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi, si dhe nuk ka bërë krahasueshmërinë e votave në Qendrat e Votimit. Prandaj Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuara me fakte dhe ankesa si e tillë nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.658/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.